



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.5.2023

Nr: 445

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AMBASADAVE AUSTRIAKE, GREKE, HUNGAREZE, HOLANDEZE, FRANCEZE, TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË MOLDAVISË, TË DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN, TË INSTITUTIT DEMOKRATIK TË KOSOVËS, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 5.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Ambasada Austriake, me adresë Rruga e Xibrakëve nr. 4, Tiranë dhe me përfaqësues z. Christian Steiner;

Ambasada Greke, me adresë rruga “Skënderbeg”, nr. 8, Tiranë dhe me përfaqësues zj.Konstantina Kamitsi;

Ambasada Hungareze, me adresë Rruga e Xibrakëve, nr. 47, Tiranë dhe me përfaqësues z. Adam Lovassy;

Ambasada Holandeze, me adresë rruga “Asim Zeneli”, Tiranë dhe me përfaqësues z. Reinout Vos;

Ambasada Franceze, me adresë “Rruga Skënderbej 14”, Tiranë dhe me përfaqësues znj. Elisabeth Barsacq.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Moldavisë, me seli në Chisinau, Moldavi dhe me përfaqësues zj. Angelica Caraman;

Delegacioni i Bashkimit Europian me seli në Tiranë dhe me përfaqësuese znj. Christiane Hohmann;

Instituti Demokratik i Kosovës, me adresë rruga “Bajram Kelmendi”, Prishtinë dhe me përfaqësues z. Bajram Kosumi.

Data: 5.5.2023 Nr: 445
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit Europian, të Institutit Demokratik të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të ambasadave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Ambasada Austriake i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Austriake është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Greke i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 14 (katërmëdhjetë) vëzhgues afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Greke është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Hungareze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Hungareze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Holandeze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Holandeze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Franceze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) vëzhgues afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Franceze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja e Moldavisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. KQZ-ja e Moldavisë është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Delegacioni i Bashkimit European i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Delegacioni i Bashkimit European është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Instituti Demokratik i Kosovës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Instituti Demokratik i Kosovës është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediae”,

V E N D O S:

1. Akreditimin e 1 (një) vëzhguesi dhe 2 (dy) përkthyesve të Ambasadës Austriake, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 14 (katërbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyesve të Ambasadës Greke, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës Hungareze, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyesve të Ambasadës Holandeze, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 5.5.2023 Nr: 445
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit European, të Institutit Demokratik të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

5. Akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të Ambasadës Franceze, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të KQZ-së së Moldavisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të Delegacionit të Bashkimit Europian, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
8. Akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatshkurtër të Institutit Demokratik të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 5.5.2023 Nr: 445
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit Europian, të Institutit Demokratik të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.